



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА


KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

BE LAJME prill/maj 2016
BEQ-numër 21/2016



REFERENDUME PËR POLITIKAT E BASHKIMIT EVROPIAN



Sipas rezultateve të referendumit të fundit të mbajtur në Holandë me të cilin u refuzua Marrëveshja për Asociim e BE-së me Ukrainën, referendumet paraqesin problem për Bashkimin Evropian.

Ish këshilltari i Komisionit Evropian, Frejzer Kameron sugjeron se numri i referendumeve po rritet dhe vështirë mund të quhen të njëjtat demokratike kur 1/3 e votuesve të një shteti të BE-së mund të bllokojnë atë që është miratuar nga 27 vende anëtare. Gjatë 20 viteve të fundit, BE-ja ka mbajtur më tepër se 50 referendume.

Sipas Frejzer Kameron, referendumi holandez ka përfunduar në mënyrën më të keqe të mundshme sepse qeveria ka mundur të injorojë nëse dalja do të ishte nën 30%. Por, sepse dalja ishte diçka mbi 30% ndërsa 64% e votuesve kanë votuar kundër marrëveshjes së Be-së me Ukrainën, qeveria duhet të konsultohet me Parlamentin se si të veprojnë në këtë rast. Të gjitha shtetet tjera anëtare të BE-së e kanë ratifikuar marrëveshjen, përfshirë edhe Kiev.

disa ide, siç është rasti në Britaninë e Madhe. Ndonjëherë qeveria beson se referendumi është vegël e dobishme për rritjen e shpejtë të popullaritetit, siç u përpoq ish presidenti francez Fransoa Miteran të bëjë me Marrëveshjen e Mastrohit.

Pa dallim të motivit, ka shumë pak prova se referendumet ndonjëherë kanë shërbyer për qëllimin për të cilin janë organizuar.

Sistemi i demokracisë përfaqësuese në Evropë është ajo që duhet të përforcohet, përmes masave për transparencë më të madhe dhe pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrjen në BE.

Ish këshilltari i Komisionit Evropian, Frejzer Kameron tërheq vëmendjen se vështirë mund të konsiderohet demokraci, nëse 30% e votuesve të një shteti mund të bllokojnë politikën për të cilat janë pajtuar të gjithë vendet tjera anëtare të BE-së. Referendumi ka kuptim nëse është në nivel të BE-së dhe vlen për disa çështje të rëndësishme siç janë zgjedhjet e drejtpërdrejta për kryetar të Komisionit Evropian.

<http://www.euractiv.com>

Përmbajtja e lajmeve:

Referendume për politikën e bashkimit Evropian	1	Rezultati nga referendumi paraqet problem edhe për kryetarin e Komisionit Evropian, Zhan - Klod Junker, i cili paraprakisht tërhoqi vëmendjen në lidhje me pasojat e "jo-së" holandeze.
Në fokusin e Parlamentit Evropian	2	
Bashkimi Evropian prezantoi regjimin klimatik për investuesit	3	Shërbimi juridik i Komisionit Evropian do të punojë në lidhje me propozim - protokollin me qëllim të merret parasysh qëndrimi i Holandës në lidhje me marrëveshjen me Holandën.
Gjendja politike dhe mediet në Evropë	4	Marrëveshja për asociim do të prolongohet, që do të inkurajojë fuqitë pro reformave në Kiev.
Rregulla të reja për mbrojtjen më të mirë të të dhënave personale	5	"Jo-ja" holandeze mund të prolongojë zgjerimin e BE-së dhe iniciativat për politika fqinjësore që do të jetë epilog shumë i dëmshëm.
Dita e Evropës dhe fitorja mbi fashizmin	6	
Rregullativë e re për promovimin e shprehive të shëndetshme shkollat	6	
Dita botërore për pronë intelektuale	7	Një nga politikanët holandez me ndikim Gert Vajle]ders theksoi se referendumi holandez dhe rezultati i tij paraqet "fillimin e fundit të BE-së"
Marrëveshje për rregulla të reja evropiane për mjete ndihmëse	8	
22 prill – Dita e Planetit Tokë	9	Ndo ndonjëherë referendumet i drejtohen Qeverisë, nëse dalin numër i mjaftueshëm i votuesve si në Holandë. Të tjerë, përdoren për
Be kalendar qershor/2016	9	

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN



Sesioni plenar 9 - 12 maj 2016

Evropol si agjenci evropiane për zbatimin e ligjit ju ndihmon vendeve anëtare në luftën kundër terrorizmit dhe krimit ndërkombëtar. Parlamenti Evropian i aprovoi planet për autorizime plotësuese për përballje më efikase me terrorizmin.

Eurodeputetët e shqyrtuan legjislacionin evropian aktual për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave dhe propozuan përmirësime në këtë fushë.

Parlamenti Evropian dha leje për harmonizimin e rregullave evropiane dhe qëndrim në BE të cilat janë të qasshme dhe atraktive për njerëzit e vendeve të treta të mësojnë ose të hulumtojnë në universitetet në BE. Me rregullat e reja sqarohen dhe përmirësohen kushtet për stazhier nga vendet jo anëtare të BE-së, vullnetarë, nxënës dhe kujdestarë.

Sesioni plenar 24 - 25 maj 2016

Evropianët debatuan në lidhje me marrëveshjen e re për mbrojtjen e të dhënave personale me SHBA. Bashkimi Evropian është në negociata për marrëveshje të re me SHBA i quajtur - Mburoja e privatësisë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjatë disa viteve të fundit në botën digjitale u paraqit valuta Bitcoin edhe pse e njëjta nuk është lëshuar nga bankat. Në Raportin për të cilin debatuan eurodeputetët u theksua se BE duhet të formojë grup pune për përcjelljen e zhvillimit të ngjarjeve në këtë sferë dhe të përgatitet valuta të përfshihet në dispozitat nëse vlerësohet se kjo është e nevojshme.

Mbreti i Holandës, Vilem Aleksander u drejtua para Parlamentit Evropian, për herë të parë nga marrja e fronit në prill të vitit 2013.

Iniciativat e reja të cilat do të mundësojnë konsumatorët dhe kompanitë më lehtë të blenë dhe të shesin produkte dhe shërbime në

internet nëpër territorin e BE-së u përshëndetën nga shumica e eurodeputetëve gjatë debatit me zëvendës kryetarin e Komisionit Evropian përgjegjës për tregun e vetëm digjital, Andrus Ansip.

Eurodeputetët gjatë seancës plenare me Komisararin evropian për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Fill Hogan dhe Zëvendës ministri Holandez i Bujqësisë Hans Høgeveen së bashku bënë thirrje BE të ndërmarrë masa plotësuese për stabilizimin e çmimeve të qumështit dhe të bëjnë lehtësime për blegtorët të cilët përballen me probleme. Masat duhet të përmbajnë limit të prodhimit të qumështit në nivel të BE-së rritjen e çmimeve dhe sistem më efikas për intervenim.

Parlamenti miratoi ndihmë prej 6,5 milion euro për 557 të falimentuar nga supermarketi "Larisa" në Greqi dhe 5,2 milion euro për 2132 ish shoferë për transport rrugor dhe dërgimin në firmën Mori Global në Francë.

Eurodeputetët votuan rezolutë për "Marrëveshjen e re energjetike për konsumatorët të energjisë" dhe bënë thirrje fondet e BE-së për efikasitet energjik të fokusohen në varfërinë energjetike.

Interneti ka për qëllim të sigurojë qasje të pa kufizuar për dije. Por, megjithatë, kur blihet në internet, mund të ekzistojë kufizim për blerjen e ndonjë produkti ose shërbimi sipas vendbanimit. Komisioni Evropian propozoi rregulla të reja për të vendosur fund përdorimit të pa arsytuar të praktikës së njohur si geo bllokim si dhe mënyra të krijohet treg i vetëm digjital i vërtetë në Evropë.

<http://www.europarl.europa.eu/news/en>

BASHKIMI EVROPIAN PARAQITI REGJIMIN KLIMATIK PËR INVESTUESIT

Ndryshimet klimatike e cenojnë sistemin klimatik, parashihet se vërshimet do të jenë gjithnjë e më të shpeshta në qytetet bregdetare. Rritet presioni i rregullatorëve global dhe Komisionit Evropian për "stres – test" portfoliot e investuesve të mëdhenj përkundër qëllimeve afatgjata për zvogëlimin e ndryshimeve klimatike. Shqyrtohen gjithnjë e më shumë iniciativa për menaxhim me investimet me teknologji me pak karbon.

Sipas AleksisDutert, zëvendës i përfaqësuesit të përhershëm të Francës në BE në Bruksel "rreziqet klimatike në mënyrë plotësuese duhet të integrohen në portofolit investuese".

Ndër 28 ministrat për Mjedis Jetësor të BE-së zhvillohen diskutime aktive për ndryshimin e tatimit ndaj energjisë më të pastër.

Dënimet mund të parashihen për investime në sektorët e karburanteve fosile, ndërsa të tjerat si p.sh., burimet ripërtëritëse të energjisë mund të shpërblehen në mënyrë pozitive me "bonus" sistem.

Franca është shtet lider në rrugën drejt financave të gjelbra dhe ishte nikoqire e konferencës botërore COP21 për ndryshime klimatike e cila u mbajt në Paris në dhjetor të vitit të kaluar. Në korrik, Franca u bë shteti i parë në botë e cila vendosi obligime të detyrueshme për njoftim për investime nga investues në lidhje me ndryshimet klimatike. Ligji i cili është në fuqi nga janari, është një nga propozim ligjet franceze për "tranzicion energjetik për rritje të gjelbër" dhe kërkon investuesit të njoftojnë në lidhje me atë se si i integrojnë faktorët ekologjik, social dhe menaxhues në politikat e tyre investuese.

Suedia ndërmori hapa të ngjashëm në drejtim të kërkesave për raportim në

lidhje me karbonin, por deri tani nuk ja doli të miratojë zgjidhje ligjore në këtë drejtim.

Iniciativat e Francës dhe Suedisë krijuan presion mbi rregullatorët e BE-së ti drejtojnë politikat nacionale drejt përbaljes me fragmentimin e Tregut të Vetëm të BE-së.

Rreziqet financiare nga tranzicioni drejt ekonomisë me nivel të ulët të karbonit në masë të madhe mund të parashihen dhe mund të evitohen, theksojnë nga sektori civil. Sipas tyre, shpenzimet do të ulen nëse tranzicioni fillon menjëherë dhe e ndjek rrugën e parashikuar.

Këshilli i Evropës për rreziqe sistemore i cili është trup përkatës me Bashkimin Evropian, që në fillim të krizës financiare në vitin 2008, tërhoqi vërejtjen për rreziqet e tranzicionit shumë të vonuar ose të hershëm ndaj ekonomisë me nivel të ulët të karbonit.

Bankat qendrore në mënyrë të barabartë tërhoqën vërejtjen për pasojat e tranzicionit të pa parashikuar. Sipas deklaratës së Bankës të Finlandës më 22 mars të këtij viti "Ngjarjet klimatike ekstreme i rritën shpenzimet për kompanitë e sigurimit dhe e ulën vlerën e dëmeve të adresuara për kreditë bankiere.

Banka e Anglisë publikoi vërejtje të ngjashme në dhjetor vitin e kaluar, duke aluduar se investuesit janë përballur me humbje të mëdha potenciale nga ndryshimet klimatike.

<http://www.euractiv.com>



GJENDJA POLITIKE DHE MEDIET NE EVROPË



Sipas MerlenVind profesorit të shkencave politike dhe drejtësisë në Universitetin e Kopenhagës "ka tendencë te politikanët dhe mediat BE të përshkruhet si përbindësh i tmerrshëm i shpërftyruar i cili ka shkaktuar krizën me të cilën përballet Evropa."

Para disa javë, instituti zviceran për hulumtime Media Tenor publikoi analizë e cila tregon se servisi britanik BBC gjatë 15 viteve të fundit ka bërë më shumë mbulim negativ për BE-në sesa vetë Putini.

Tani është dokumentuar me faktin se vetëm 7% e mbulimit të BBC gjatë 15 viteve të fundit ka qenë BE pozitive. Vetëm gjatë vitit të kaluar 45% e mbulimit ka qenë drejtpërdrejtë negativ.

Por trendi i ri i madh në mbulimin e lajmeve nacionale nuk është rast vetëm me mediat Britanike.

Gazeta daneze Berlingske e cila paraprakisht kishte profil mjaft pro evropian, kohë më parë publikoi në dy faqe BE intervistë të pa përcaktuar negative me ministrin e Punëve të Jashtme KristijanJensen (Liberal).Një ditë më vonë, lideri partiak i Partisë Popullore Daneze, Tulesen Dal fitoi vëmendje të madhe në dy faqe të plota dhe pa i paraqitur pyetje kritike. Me shtrimin e pyetjes – çfarë kanë menduar redaktorët se është e rëndësishme të dinë lexuesit danez, se Tulesen Dal dëshiron të ndjekë Britanikët nëse ndodh Brexit?

Ajo që e karakterizon debatin për Evropën për momentin me fjalë të tjera është hip të jesh euroskeptik. Kjo siguron erën në kurriz për cilin do imitues, komentues ose redaktor politik i cili dëshiron të bëhet popullor dhe të bëjë veten interesant.

Siç shkruan MarlenVing, Bashkimi Evropian nuk është ndonjë monstër abstrakte dhe nuk bën as më shumë as më pak nga ajo që vendet anëtare dëshirojnë të bëhet.

Komisioni Evropian (të cilin gazetarët shpesh e përdorin si sinonim për BE) vetë nuk i miraton vendimet. Komisioni propozon zgjidhje në gamë të gjerë të fushave, nga ndryshimet klimatike deri të rregullat dhe tregtia. Shembulli i fundit është propozimi për politikë të përbashkët për refugjatët.

Komisioni nuk është jo aktiv në lidhje me invazionin e refugjatëve që ndodhi në kufijtë e Evropës. Përkundrazi, Komisioni paraprakisht me vite theksonte se madje edhe prurje shumë e madhe e refugjatëve janë rrezik politik i cili duhet të kuptohet seriozisht.

Bashkëpunimi me BE-në është diçka e shkëlqyer, në veçanti e rëndësishme për popujt më të vegjël të cilët kanë mundësi të ndikojnë në botë në mënyrë konstruktive.

<http://www.euractiv.com/section/future-eu>

НОВИ ПРАВИЛА ЗА ПОГОЛЕМА ЗАШТИТА НА ЛИЧНИТЕ ПОДАТОЦИ

Rregullat e reja të BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale kanë për qëllim kthimin e besimit të qytetarëve, kontrollin mbi të dhënat e tyre personale dhe të krijojnë nivel të lartë dhe të barabartë të mbrojtjes në të gjithë BE-në.

Rregullat e reja përfundimisht u aprovuan nga eurodeputetët më 14 prill të këtij viti. Parlamenti Evropian miratoi për herë të parë një sërë rregulla për 28 shtetet anëtare me qëllim të mbrohet privatësia e shfrytëzuesve të internetit.

Me këtë reformë vendosen standarde minimale për shfrytëzimin e të dhënave për qëllime policore dhe të jurisprudencës.

Votimi në Parlamentin Evropian i vuri fund punës më të gjatë se katër vjet në lidhje me rregullat e BE-së për mbrojtjen e të dhënave.

Reforma do të kontribuojë të ndryshohet direktiva për mbrojtjen e të dhënave e cila daton që nga vitit 1995 nga koha kur interneti akoma ishte në fazë fillestare dhe për publikun më të gjerë paraqiste vetëm një të ardhme.

Rregulla e re duhet qytetarëve tu sigurojë kontroll më të madh mbi të dhënat e tyre personale në botën digjitale të smatfonëve, medieve sociale, shërbimeve bankiere në internet dhe transferimeve globale.

Rregullativa e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale siguron nivel dukshëm më të lartë dhe të barabartë të mbrojtjes së të dhënave në të gjithë BE-në.

"Ky është sukses i madh për Parlamentin Evropian dhe paraqet "po" të sigurt evropiane për të drejta të fuqishme të konsumatorëve dhe konkurrencës në erën digjitale. Vetë qytetarët do të vendosin për vete cilat informata personale dëshirojnë ti ndajnë" theksoi Jan Filip Albreht, deputet

në Parlamentin Evropian nga radhët e të gjelbërve.

"Propozim ndryshimet e reja në rregullativën për mbrojtjen e të dhënave personale në BE gjithashtu do të krijojnë vizion të qartë dhe biznes klimë të mirë, rregullativa e re do të vendosë ligj të vetëm për të gjithë BE-në. Me rregullat e reja të gjithë do të kenë interes të barabartë, besim, siguri juridike dhe ferkonkurrencë", shtoj Albreht.

Rregullat e reja për mbrojtjen e të dhënave personale përfshijnë dispozita për:

-Të drejtën të jesh i harruar (të dhënat duhet të shlyhen menjëherë sapo mos ketë nevojë për të njëjtat).

-Pëlqim eksplicit dhe pozitiv për përpunimin e të dhënave personale nga personi i tanguar,

- e drejta e transferit të të dhënave te operator tjetër,

-E drejta për njoftim nëse të dhënat janë zbuluar,

-Sigurimi i politikave të privatësisë, të sqarohen në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme dhe – zbatim i përforcuar i ligjit dhe dënime deri në 4% të qarkullimit të përgjithshëm të kompanisë përkatëse.

Rregullativa hyn në fuqi 20 ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të BE-së. Vendet anëtare të BE-së do të kenë dy vjet kohë të transponojnë dispozitat e direktivës në legjislacionin nacional.

Për shkak të statusit special të Britanisë së Madhe dhe Irlandës, në lidhje me legjislacionin e BE-së në sferën e drejtësisë dhe punëve të brendshme, dispozitat e direktivës do të zbatohen vetëm deri në një shkallë të kufizuar në këto vende, ndërsa Danimarka do të mund të vendosë gjashtë muaj pas miratimit përfundimtar të direktivës nëse dëshiron ta transponojë në legjislacionin nacional.

<http://www.europarl.europa.eu/news>



МАКЕДОНИЈА ГИ ОДБЕЛЕЖА ДЕНОТ НА ЕВРОПА И ПОБЕДАТА НАД ФАШИЗМОТ



Me më tepër aktivitete më 9 maj në Republikën e Maqedonisë u kremtua dita e Evropës dhe lufta kundër fashizmit.

Me rastin e Ditës të Evropës, Agjencia nacionale për Programe Evropiane, dhe "Eunik" klasteri në Maqedoni, organizuan punëtori me titull "Të rinjtë dhe mobiliteti" me qëllim tu ofrojnë mënyra të rinjve si të kalojnë periudhë të caktuat të studimeve ose praktikën në disa institucione evropiane.



Në vitin 1950 më 9 maj ministri i atëhershëm francez për Punë të Jashtme Robert Shuman doli me propozim për krijimin e komunitetit të thëngjillit dhe çelikut ndërmjet Francës dhe Gjermanisë Perëndimore plan që bazohej në idenë fillestare të Zhan Mone. Çdo vit më 9 maj kremtohet si "Dita e Evropës".

ПРОМОЦИЈА НА ЗДРАВИ НАВИКИ ВО УЧИЛИШТАТА



Këshilli i BE-së miratoi rregullativë e cila është në drejtim të promovimit të konsumit të qumështit, frutave dhe perimeve në shkolla.

Ushqimi i balancuar paraqet bazën e shëndetit të mirë. Kohët e fundit konsumi i frutave, perimeve dhe qumështit po ulet në BE. Ky është shkaku pse promovimi i ushqimit të shëndetshëm është me rëndësi të madhe për përforsimin e skemës së ushqimit në shkolla.

Nga buxheti vjetor për dedikim parashihen 250 milion euro prej të cilave 100 milion euro për produkte të qumështit dhe 150 milion euro për perime dhe fruta. Me mjetet financiare për këtë skemë, duhet të promovohen shprehi të shëndetshme të ushqimit, produkte të shëndetshme në dyqanet lokale, bujqësi organike dhe mënjanim i përditshëm i rregullt i mbetjeve të ushqimit. Fëmijët

duhet të njohën me bujqësinë, të mësojnë nëpërmjet fotografive dhe të vizitojnë ferma.

Skema për fruta perime dhe skema për qumësht në shkolla për momentin janë programe të veçanta. Me rregullativën e re programet do të bashkohen në një, ndërsa rregullat e reja do të zbatohen nga gushti i vitit 2017.

Hungaria dhe Holanda kanë votuar kundër miratimit të rregullativës ndërsa Britania e Madhe ka abstenuar nga votimi.

<http://www.consilium.europa.eu>

DITA BOTËRORE E PRONËS INTELLEKTUALE 2016

Dita botërore e pronës intelektuale për vitin 2016 u fokusua në mbrojtjen e interesave të atyre që e krijojnë dhe e zbulojnë pronën intelektuale. Gjithashtu procesi i kultivimit të bimëve, në mënyrë që do të vazhdojë me krijimin e sortave të reja të përmirësuara është pronë intelektuale. Kultivimi i llojeve të ndryshme të bimëve ose zhvillimi i sortave të reja kërkon kohë të konsiderueshme (deri në 15 vjet) dhe investime.

Pa të ardhura potenciale nga të drejtat e autorit, nuk ka nxitje për kultivuesit që të zhvillojnë sorta të reja dhe të përmirësuara.

Si agjenci e BE-së përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të sortave bimore, Zyra e Komunitetit të Bimëve të Ndryshme duhet të sigurojë kultivuesit të kenë mundësi lirisht të punojnë, ndërsa me të drejtat e sortave të bimëve të sigurojë se kultivuesit do të fitojnë kompensim të drejtë për sortat e reja.

Dita botërore e pronës intelektuale është mundësi e shkëlqyete të krijojë vetëdije për rolin e sistemit të pronës intelektuale.

Zyra e Komunitetit të Bimëve të Ndryshme (CPVO) i monitoron dhe implementon sistemin më të madh të të drejtave intelektuale për bimë në botë, duke bashkëpunuar ngushtë me organizata të cilat merren me kultivimin e bimëve siç janë Ciopora, ESA dhe Plantum.

Në ditën botërore të pronës intelektuale dhe rolin e të drejtave nga prona intelektuale në kultivimin e bimëve organizatorët theksuan se:

- Kultivimi është inovacion dhe krijim i bazuar në biznes, i cili duhet të jetë efikas që ta mbrojë pronën intelektuale dhe të sigurojë se kultivuesit mund të vazhdojnë më inovacione dhe të krijojnë lloje të reja dhe më të mira të frutave për shoqërinë - CIOFORA.

- Industria evropiane e farave e mbështet sistemin e të drejtave të kultivuesve si sistemin më të përshtatshëm për mbrojtjen e pronës intelektuale të sortave bimore dhe interesave të publikut

njëkohësisht, me sigurimin e kompensimit të drejtë për investimin e kultivuesve për inovacionet e tyre dhe garantimin e qarkullimit të vazhdueshëm të llojeve më të mira të bimëve me mbrojtjen e qasjes së diversitetit gjenetik - ESA.

- Kultivimi i bimëve kontribuon dukshëm në prodhimin më të qëndrueshëm dhe më të ndryshëm bimor ndërsa me këtë edhe në sigurimin global të ushqimit. Të drejtat e kultivuesve janë baza e investimeve në kultivim me qëllim të sigurojnë përfitime të ndryshme për shoqërinë - Plantum

Të drejtat e prinës intelektuale e mbrojnë integritetin dhe konkurrencën në tregun e BE-së duke mbrojtur konsumatorët nga falsifikime dhe sorta pirate.

Rregullativa për pronë intelektuale nxit inovacione dhe kreativitet te investuesit me zgjidhje më të madhe dhe prodhime më të mira për konsumatorët, theksoi MartinEkvad kryetar i CPVO.


Rreth 39% e numrit të përgjithshëm të aktivitetit ekonomik të BE-së krijohet nga të drejtat e pronës intelektuale ndërsa 1/3 (35%) e të gjitha vendeve të punës në BE mbështeten në të drejtat e pronës intelektuale- industri të fuqishme.

CIOFORA është komunitet ndërkombëtar i kultivuesve të sortave frutore aseksuale reproduktive ornamentale.

Asociacioni Evropian për fara (ESA) është zëri i industrisë evropiane të farave e cila përfaqëson interesat e atyre që janë aktiv në hulumtime, kultivim, prodhim dhe marketing të farave bujqësore, kopshtare dhe ornamentale.

Plantum është asociacion holandez në sferën e shumimit të bimëve.

<http://www.cpvo.europa.eu>



MARRËVESHJE PËR RREGULLA TË REJA EVROPIANEPËR MJETE NDIHMËSE MJEKËSORE



Këshilli i Bashkimit Evropian më 25 maj të këtij viti në kuadër të kryesimit Holandez së bashku me Parlamentin Evropian arritën marrëveshje të përkohshme për rregullat e reja për mjete ndihmëse mjekësore dhe invitro prodhime diagnostike. Marrëveshja formalisht duhet të aprovohet nga Këshilli dhe Parlamenti Evropian.

Qëllimi i rregullave të reja është të sigurohet se mjetet ndihmëse mjekësore dhe invitro produktet për diagnostifikim janë të sigurta dhe pacientëve tu jepet qasje e shpejtë drejt mjeteve ndihmëse inovative.

Mjetet ndihmëse mjekësore dhe produktet për dijagnostifikim invitro janë ngjitje e gipsit, këllqe artificiale dhe pejsmejker deri në teste laboratorike dhe teste në kushte shtëpie për shtatzëni. Ministri holandez i shëndetësisë Edit Shiper deklaroi se ky është një hap i rëndësishëm për njerëzit në Evropë sepse më herët ose më vonë të gjithë do të kemi nevojë për mjete ndihmëse mjekësore. Mjete ndihmëse të sigurta dhe inovative e përmirësojnë cilësinë e jetës dhe shëndetin e pacientëve. Rregullat e reja gjithashtu do të krijojnë kushtet e nevojshme për funksionimin e drejtë në tregun e brendshëm për 25.000 prodhues të mjeteve ndihmëse në BE.

Rregullat e reja do të garantojnë sigurinë e mjeteve ndihmëse mjekësore në dy mënyra:

- Nëpërmjet vendosjes të rregullave më të rrepta për shitjen e pajisjeve dhe
- Monitorim më i rreptë mbasi pajisjet do të gjenden në treg.

Kërkesat për trupa të caktuar të cilët janë përgjegjës për autorizim në treg do të jenë më të rrepta, ndërsa do të përforcohet edhe mbikëqyrja mbi të njëjtat.

Janë përcaktuar rregulla të qarta për prodhuesit që të garantohet kualitet, efikasitet dhe siguri të pajisjeve mbasi të njëjtat do të kenë qasje në treg.

Me rregullat e reja do të vendosen edhe kërkesa më të rrepta për hulumtime klinike dhe hulumtime të refomancave. Mbrojtja e subjektit njerëzor në hulumtimet klinike është një nga momentet kyçe.

Hulumtime plotësuese, nga ekspertë, mund të kërkohen para disa pajisjeve mjekësore të caktuara me rrezik të lartë të cilat do të gjenden në treg, si për shembull implante dhe produkte për invitrodiagnostifikim të rrezikshme për jetën.

Panelet e ekspertëve të pavarur dhe laboratorët do të luajnë rol të rëndësishëm në të ardhmen e sistemit juridik. Nëse nevojitet ato mund të japin organe të

caktuara, qeveritarë kompetent dhe prodhues, ekspertiza dhe këshilla për aspekte klinike të mjeteve ndihmëse mjekësore. Produkte të caktuara me rrezik të lartë të cilat janë të ngjashme me mjetet ndihmëse mjekësore por për momentin nuk i nënshtrohen rregullave të këtylla siç janë lidhëset për rrudha dhe thjerrëzat kontakte me ngjyrë, do të përfshihen nga kjo rregullativë.

Transparenca me mjetet ndihmëse mjekësore do të përmirësohet në mënyrë enorme me bazën e madhe të pajisjeve të cilat përmbajnë shumë informata për prodhuesit, importuesit, shpërndarësit, trupat kompetente, të dhëna për mbikëqyrjen në treg, rezultate nga hulumtime klinike dhe certifikata.

Pacientët, punëtorët shëndetësorë dhe publiku do të kenë qasje drejt informatave me detaje për prodhime të cilat janë të qasshme në tregun e Evropës, duke mundësuar informatat që të bëjnë zgjidhje të mirë. Pacientëve me implant do tu jepen informata konkrete për prodhuesin, përfshirë të gjitha masat e nevojshme për kujdes. Prodhuesit do të detyrohen në pajisjen e tyre të vendosin kodin e vetëm për identifikim, që do të japë mundësi produkti të përcillet gjatë gjithë zinxhirit të shpërndarjes.

Kryesimi holandez me BE-në do ti prezantojë rezultatet e negociatave të vendeve anëtare për aprovimin e tyre në mes të muajit qershor. Rregullat e reja për mjete ndihmëse mjekësore do të hynë në fuqi 3 vjet nga dita e botimit, ndërsa rregullat për mjete ndihmëse mjekësore për produkte diagnostifikuese invitro për 5 vjet nga dita e botimit.

<http://www.consilium.europa.eu>

22 PRILL—DITA E PLANETIT TOKË

Më 22 prill 2016 u shënuar Dita e Planetit Tokë me moton “Çfarë presim? Tani është koha”.

Tani më 46 vjet, Lëvizja – Dita e Planetit Tokë vazhdon me rritjen dhe bashkëpunimin me qëllim të rritet niveli i vetëdijes për rruajtjen e mjedisit jetësor.

Për herë të parë Dita botërore e Planetit Tokë u shënuar më 22 prill 1970 në SHBA si rezultat i teorive të shkencëtarëve amerikanë se atë ditë do të ndodhë "demonstrim" i të gjitha resurseve natyrore në tokë. Në ngjarjen kanë marrë pjesë mbi 20 milion qytetarë, duke protestuar kundër ndotjes dhe materialeve toksike.

Çdo ditë duhet të jetë ditë e Planetit Tokë ta rruajmë natyrën, të nxisim vetëdijen dhe krijimin e mjedisit jetësor të shëndetshëm nëpërmjet gjelbërimit të vendbanimeve.

Lëvizja dërgoi mesazh të të gjitha organizatat në 196 vende të botës që të realizojnë projektin më ambicioz deri tani, të mbjellin 7.8 miliardë drurë gjatë pesë viteve

të ardhshme. Me këtë iniciativë do të lihet shenjë e konsiderueshme mbi planetin Tokë dhe do të krijohet bazë për planet më të pastër më të shëndetshëm dhe më të qëndrueshëm për të gjithë ne.

Shumë organizata dhe shoqata luftojnë për rruajtjen e natyrës, deteve, ujit për pije, pyjeve dhe resurseve tjera natyrore. Motoja e tyre është se njeriu duhet të ndryshojë sjelljen e tij dhe të mos i shkatërrojë më të gjitha pasuritë dhe bukuritë natyrore të Tokës.

Dita e planetit Tokë në Republikën e Maqedonisë u kremtua me aktivitete të ndryshme. Qyteti Shkup dhe Shoqata për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor “GoGreen” në Parkun e Qytetit e shënuan 22 prillin – Ditën e Planetit Tokë.


<http://www.earthday.org/earth-day/>



BE KALENDARI Qershor 2016

1. Seanca plenare e Parlamentit Evropian, 06-10/06/2016, Strazburg
2. Java e eShëndetësisë, 08-10.06.2016, Amsterdam, Holandë
3. Java e rajoneve inovative në Evropë, 08-10.06.2016 Ajnhoven, Holandë
4. Java Evropiane e energjisë së qëndrueshme, 14-16.06.2016, Bruksel, Belgjikë
5. Ditët Evropiane të Zhvillimit, 15-16/06/2016, Bruksel, Belgjikë
6. Sesioni plenar i Komitetit Evropian të Rajoneve, 15.06.2016, Brukes, Belgjikë
7. Takim i Këshillit Evropian, 23-24.06.2016, Bruksel, Belgjikë
8. InnoGrid 2020+ Konferenca për “Energji digjitale”, 27-28/06/2016, Bruksel, Belgjikë

About this site | RSS | Sitemap | Legal notice | Cookies | Contact | English (en)

 **European Union**
Newsroom
europa.eu

EUROPA > Newsroom > Calendar

Home | Highlights | Press releases | **Calendar** | Audiovisual | Press contacts | Press facilities | About the EU

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic
Choose a topic

By organiser
Choose an organiser

By type
Choose a type

BY MONTH

June

Sun	Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Tetor nr. 10, Shkup, 1000

telefon: +389 2 3 11 22 33 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

Sektor i për mbështetjen e Këshillit Nacional
për Eurointegritime

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë gjatë periudhës janar 2011 qershor 2012 u realizua projekti IPA për "Ndihmë teknike për Parlamentin" qëllimi kryesor i të cilit ishte përforsimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me këtë përmirësimin e transparencës dhe përgjegjësisë të tij para qytetarëve.

Në kuadër të IPA projektit, u sigurua ndihmë financiare dhe profesionale për vendosjen e BE qendrës në Kuvend.

Qëllimi i formimit të BE qendrës është që deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit tu sigurojë qasje më të mirë drejt informatave në lidhje me BE çështje.